



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-

Tiranë, 22 Korrik 2009

Njoftim për shtyp

Autoriteti i Konkurrencës organizon një takim pune me grupet e interesit për prezantimin e ndryshimeve të propozuara në Ligjin Nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me GTZ, organizuan një takim pune me përfaqësuesit e komunitetit të biznesit, studiove ligjore dhe institucioneve publike, për të diskutuar ndryshimet e propozuara në Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Gjithashtu në këtë takim u prezantuan edhe projekt rregullorja e re mbi gjobat dhe lehtësimin prej tyre, si dhe projekt-rregullorja mbi marrëveshjet e rëndësisë së vogël (*De minimis*).

Përmirësimi i Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës është një iniciativë e vetë Autoritetit të Konkurrencës, me mbështetjen e GTZ, e cila ka ofruar asistencën e një eksperti ndërkombëtar të së drejtës së konkurrencës. Amendimi i Ligjit ka si qëllim kryesor përmirësimin e Ligjit si rezultat i zbatimit të tij, si dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Plani kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA).

Eksperienca 5 vjeçare në zbatim të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 nga Autoriteti i Konkurrencës, institucion i krijuar nga ky ligj, mundësoi realizimin e vlerësimit të zbatimit të ligjit dhe evidentimin në praktikë të disa problemeve. Këto probleme kanë të bëjnë me pamjaftueshmërinë e të kuptuarit nga ana e subjekteve dhe institucioneve që janë zbatuese të tij dhe të mbrojtura prej tij, mosrespektimi, kufizimi dhe shkelja e konkurrencës, ose te drejta të tjera të lidhura me të, mosfunksionimi sa duhet i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve dhe subjekteve të lidhura me zbatimin dhe respektimin e këtij ligji, si dhe nevoja për përmirësimin dhe plotësimin e procedurave të masave dhe sanksioneve ndaj subjekteve që shkelin dispozitat e këtij ligji. Rritja e forcës zbatuese kërkon jo vetëm përdorimin e instrumentit të gjobës, por edhe të nxitjes së bashkëpunimit të palëve të prekura nga praktikatat anti-konkurrese nëpërmjet instrumentit të ankesës.

Përafrimi i Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” me atë të së Drejtës së Konkurrencës të BE-së, por edhe me gjerë, duke marrë parasysh në këtë pikë përvojat më të mira të BE-se, vendeve anëtare të saj dhe ato të vendeve të zhvilluara jashtë BE-së, ka pasur parasysh detyrimet dhe afatet që burojnë nga PKZMSA-ja për implementimin e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe direktivave që kanë të bëjnë me forcimin e kontrollit për mbrojtjen e konkurrencës; përdorimin e mekanizmave dhe rritjen e efikasitetit të institucioneve zbatuese të ligjit ekzistues, si dhe përmirësimin e procedurave dhe sanksioneve ndaj subjekteve që shkelin dispozitat e këtij ligji.

Rregullorja e re për gjocat dhe lehtësimin prej tyre ka si synim që të përshtatë legjislacionin shqiptar me rregulloret e BE që janë aktualisht në fuqi, në fushën e përlllogaritjes së masës së gjobës si dhe mundësinë e lehtësimit nga gjoca për ato ndërmarrje që bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës, për zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara (karteleve).

Ndërsa rregullorja për marrëveshjet e rëndësisë së vogël, ose “*de minimis*”, kanë si qëllim që të përjashtojnë nga zbatimi i legjislacionit të konkurrencës për ndalimin e marrëveshjeve, për ato ndërmarrje të cilat kanë një pjesë shumë të vogël të tregut përkatës dhe në këtë mënyrë, nuk mund të ndikojnë në shtrembërimin e konkurrencës së lirë dhe efektive. Kjo rregullore mbështetet në rregulloren përkatëse të BE. (*de minimis notice*).

Miratimi i shpejtë i rregulloreve të sipërpërmendura dhe veçanërisht të ndryshimeve në Ligjin 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, do të ndikojë në përmirësimin e zbatimit të politikës së konkurrencës si dhe në plotësimin e detyrimeve të Shqipërisë për integrimin në BE.